



## RISQET E POLITIZIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL SHQIPTAR: PËRJASHTIMET NGA FUSHËVEPRIMI I LIGJIT PËR NËNPUNËSIT CIVIL DHE INTEGRITETI I REKRUTIMIT TË NËNPUNËSVE TË LARTË CIVILË.

DHJETOR 2021



This Project is financed by the European Union

**Autor:** Alban Dafa

## HYRJE

Integriteti profesional i shërbimit civil mbetet ndër sfidat kyçe në përpjekjet e reformës në administratën publike (RAP) në Shqipëri. Sfidat e integritetit të shërbimit civil kanë efekte thellësisht negative mbi politikat publike pasi lehtësojnë formimin e rrjeteve klienteliste dhe hartimin e politikave që favorizojnë interesa korruptive private duke abuzuar me besimin dhe paratë e taksapaguesve.

Struktura të tilla korruptive, të cilat rëndojnë shtetin dhe i shkaktojnë vendit dëme serioze afatgjata, mbahen përmes politizimit të administratës publike të vendit dhe – më konkretisht – shërbimit të saj civil. Në këtë dokument politikash, politizimi i shërbimit civil diskutohet në kuadër të përjashtimeve nga fushëveprimi i legjislationit në fuqi për shërbimin civil dhe të mangësive të sistemit të rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve të lartë civilë. Punimi bazohet në gjetjet e raportit Monitorimi i RAP 2019/2020<sup>1</sup> duke e zgjeruar analizën për këto dy çështje.

## SFONDI

Marrëdhëniet pas-komuniste midis administratës së qeverisë qendrore dhe partive politike në Shqipëri janë njolesur nga trashëgimia komuniste. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë nuk kishte praktikisht asnjë dallim mes shtetit shqiptar dhe Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH). Organi qendror vendimmarrës i vendit ishte Komiteti Qendror i PPSH-së dhe qeveria zbatonte vendimet e Komitetit. Megjithë ndryshimet demokratike të fillimit të viteve 1990, të cilat ndërprejnë marrëdhëniet e deriatëhershme midis Partisë dhe qeverisë dhe lejuan krijimin e partive të tjera politike, tendenca e partive qeverisëse për të siguruar punësim shtetëror për anëtarët e tyre dhe për të emëruar disa prej tyre në postet kryesore të shërbimit civil ka vazhduar.<sup>2</sup>

Patronazhi politik është bërë një mjet i rëndësishëm për pasurimin e politikanëve dhe zyrtarëve publikë të korruptuar. Tendenca drejt privatizimit të pronave dhe shërbimeve publike ka paraqitur mundësi të konsiderueshme për korrupsion dhe abuzim me pushtetin.<sup>3</sup> Këto dinamika dhe trashëgimia e marrëdhënieve shtet-parti kanë qenë pengesa të vështira që kanë penguar një reformë gjithëpërfshirëse të shërbimit civil që do të siguronte profesionalizmin dhe integritetin e tij.

Në vitin 1996, Shqipëria miratoi ligjin e saj të parë për shërbimin civil, por ai përmbante dispozita të paqarta e të pamjaftueshme për rregullimin e shërbimit civil. Ligji krijoi Komisionin e Shërbimit Civil si organin kryesor rregullator për rekrutimin dhe promovimin e nëpunësve civilë. Anëtarët e komisionit emëroheshin nga Këshilli i Ministrave dhe detyrat e tyre do të ushtroheshin nëpërmjet nënkomisioneve, të cilat ishin komisione përzgjedhëse të krijuara në çdo institucion në nivel qendror dhe vendor. Ligji nuk përmbante dispozita të qarta për procedura të hapura dhe meritokratike për të konkurruar për një pozicion nëpunësi civil dhe përfshinte dispozita që përjashtonin detyrime për konkurrencë të hapur në raste të caktuara. Konceptualisht, ligji konsideronte si zyrtarët politikë

**Pavarësisht përmirësimeve që ka sjellë Ligji për Nëpunësin Civil, disa boshllëqe dhe mungesa dispozitash ligjore paraqesin risqe të theksuara politike.**

detyrë në shërbimin civil, si dhe të zhvillonte, zbatonte dhe monitoronte politikatat e shërbimit civil. Pozicionet e shërbimit civil u ndanë në katër kategori dhe gjithashtu u krijua Komisioni i Shërbimit Civil për të mbikëqyrur qeverisjen e shërbimit civil dhe zbatimin e politikave. Përkundër këtyre përmirësimeve të rëndësishme dhe thelbësore, anëtarët e Komisionit dhe nëpunësit civilë u lejuan të jenë anëtarë të partive politike.

Ligji për Nëpunësin Civil (LNC) i vitit 2013<sup>6</sup> ka ndryshuar ndjeshëm procesin e përzgjedhjes të nëpunësve civilë. Legjislacioni përcakton kriteret e qarta për emërimet në shërbimin civil dhe siguron mbrojtje të mjaftueshme ligjore nga shkarkimet për arsye politike. Janë bërë gjithashtu hapa të rëndësishëm drejt transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit më të madh në procesin e përzgjedhjes; megjithatë, disa boshllëqe dhe dispozita të paqarta ligjore paraqesin rreziqe të rëndësishme politike që kërcënojnë këto arritje.

## PËRJASHTIMET NGA FUSHËVEPRIMI I LIGJIT PËR NËPUNËSIT CIVIL

Përrjashtimet nga fushëveprimi horizontal dhe vertikal i legjislacionit për shërbimin civil cenojnë integritetin dhe profesionalizmin e shërbimit civil duke mundësuar emërimet politike dhe duke lehtësuar skemat të klientelizmit politik<sup>7</sup> Përrjashtimet nga shtrirja horizontale i japin udhëheqjes politike – kryeministrit dhe ministrave – kompetenca për të emëruar dhe shkarkuar drejtorët e agjencive publike<sup>8</sup> ndërkohë që të njëjtëve drejtorë u jepen kompetenca të ngjashme për të emëruar ose shkarkuar punonjësit e tyre në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës që ofron shumë më pak mbrojtje për punonjësit sesa LNC-ja. Për rrjedhojë këto institucione përrjashtohen krejtësisht nga shërbimit civil.

Këto përrjashtime janë bërë të zakonshme për administratën e qeverisë qendrore. Ato përfshijnë një sërë institucione në varësi të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) ose të ministrave të linjës. Sipas raporteve të viteve 2016 dhe 2017 të SIGMA-s për Shqipërinë, arsyetimet për përrjashtime të tilla janë të paqarta, por të japin përshtypjen se këto përrjashtime janë për shkak të një keqinterpretimi të klauzolës të "ofrimit të shërbimeve publike". Përrjashtimet nga shtrirja vertikale – p.sh. emërimet politike të drejtuesve të institucioneve në varësi të ZKM-së ose ministrave të linjës të cilat janë përrndryshe subjekt të LNC-së – pretendohet se kryhen për shkak të ligjeve të veçanta<sup>9</sup>

**Megjithëse disa institucione teknikisht janë subjekt i Ligjit për Nëpunësin Civil, ato janë përrjashtuar në fakt nga fushëveprimi vertikal dhe horizontal i ligjit.**

Neni 2 përrshkruan objektin e Ligjit për Nëpunësin Civil dhe përrfshin kategoritë e punonjësve publikë që përrjashtohen. Neni vëren se "personeli i njësive publike direkte të shërbimeve" përrjashtohet nga fushëveprimi i ligjit. Neni 4/dh) i përrkufizon njësitë publike direkte të shërbimeve si njësi administrative që ofrojnë drejtpërrdrejt shërbime publike në arsimin parauniversitar dhe universitar, shëndetësi, kulturë, sport, art, asistencë sociale dhe shërbime të tjera shoqërore. Personeli i ofrimit të shërbimeve sipas kësaj dispozite do të përrfshinte profesionistë të arsimit, profesionistë të kujdesit shëndetësor, artistë dhe atletë, punonjës socialë dhe profesionistë të tjerë që janë të punësuar në njësitë e ofrimit të shërbimeve të direkte. Megjithatë, ligji nuk përrcakton se ç'kuptohet me "shërbime të tjera shoqërore" dhe kjo klauzolë mund të përrdoret për të justifikuar përrjashtimin – për shembull – të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) duke pretenduar se ajo ofron një shërbim shoqëror publik, pra miradministrimin e efektshëm të burimeve natyrore, edhe pse një pretendim i tillë nuk do të ishte i saktë.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 9.8.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" (i ndryshuar), një nga detyrat kryesore të Agjencisë është "të konsultohet, të propozojë dhe të bashkëpunojë me institucionet e tjera qeveritare për hartimin e politikave të saj për [miradministrimin] e mineraleve, hidrokarbureve dhe energjisë".<sup>10</sup> Edhe pse roli i AKBN-së për hartimin dhe zbatimin e politikës së vendit për shfrytëzimin e burimeve natyrore është përrshkruar qartë, ky institucion është plotësisht i përrjashtuar nga fushëveprimi i LNC-së: drejtuesi i institucionit emërohet nga ministri përrgjegjës për energjinë, ndërsa marrëdhëniet e punës të personelit të saj rregullohen nëpërrmjet Kodit të Punës.<sup>11</sup>

Një rast i ngjashëm është ai i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). AKSHI është përrgjegjës jo vetëm për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara të qeverisë, por në thelb për (i) hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit për zbatimin e politikave të teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe (ii) për zhvillimin e politikave dhe strategjive për shoqërinë e informacionit.<sup>12</sup> Kreu i AKSHI-t emërohet nga kryeministri, ndërsa marrëdhëniet e punës të personelit të tij rregullohen nëpërrmjet Kodit të Punës.<sup>13</sup>

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), të dy drejtorët e përgjithshëm emërohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në të dyja rastet, marrëdhëniet e punës të personelit të tyre – duke përfshirë ata të angazhuar në role mbështetëse ose administrative – rregullohen përmes legjislacionit të shërbimit civil. Në rastin e DPD-së, legjislacioni i shërbimit civil zbatohet për emërimin e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm dhe pjesës tjetër të personelit, me përjashtim të drejtuesve të kategorisë së lartë.<sup>14</sup> Në rastin e DPT-së, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” përcakton se emërimi i zëvendës drejtorit të përgjithshëm dhe i personelit bëhet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.<sup>15</sup> Në të dyja rastet, ligjet që vendosin për organizimin e dy drejtorive nuk janë amenduar në përputhje me dispozitat e LNC-së.

Përjashtime të tjera të dukshme përfshijnë Autoritetin Rrugor Shqiptar – drejtori i përgjithshëm i të cilit emërohet nga kryeministri – dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit – drejtori i përgjithshëm i të cilit emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastin e parë, marrëdhëniet e punës të personelit rregullohen me Kodin e Punës<sup>16</sup>; në rastin e dytë, ato rregullohen nëpërmjet legjislacionit të shërbimit civil.<sup>17</sup>

Këto përjashtime bëhen edhe më të çuditshme pasi këto institucione, si dhe departamente e agjenci të tjera, konsiderohen si subjekt i legjislacionit për shërbimin civil sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.<sup>18</sup> Përfshirja e këtyre institucioneve në VKM nr. 142 ndërkohë që ato janë efektivisht të përjashtuara nga fushëveprimi horizontal dhe vertikal i LNC-së jep përshtypjen e një zbatim të gabuar të ligjit.

## REKRUTIMI DHE EMËRIMI I NËPUNËSVE TË LARTË CIVILË

Përveç risqeve të politizimit të institucioneve të përjashtuara nga fusha e zbatimit të LNC-së, disa sfida në sistemin e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve të lartë civilë paraqesin risqe shtesë të integritetit për pozicionet e trupës të nivelit të lartë drejtues (TND).

**Risqet politike për pozicionet e trupës së nivelit të lartë drejtues (TND) përfshijnë: (1) masa të pamjaftueshme për të siguruar që kandidatët për TND nuk kanë përkatësi politike; (2) mungesë kriteresh specifike për ekspertizën e domosdoshme për pozicionin; (3) mungesë kufizimesh në kohë për zëvendësimet e përkohshme.**

Nëpunësve të lartë civilë u ndalohej të jenë anëtarë të partive politike<sup>19</sup>; megjithatë, nuk ka rregullore për të verifikuar statusin politik të tyre. Si Ligji për Nëpunësin Civil, ashtu edhe akti nënligjor<sup>20</sup> i miratuar për të rregulluar rekrutimin dhe emërimin e nëpunësve civilë të lartë nuk përfshin asnjë kërkesë që kandidatët për pozicione TND të paraqesin ndonjë dokumentacion për të verifikuar statusin e tyre politik. Ndërkohë, ka kërkesa të qarta për ekspertët e jashtëm që janë anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes (KKP)<sup>21</sup>, e cila është përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për pozicionet TND. Atyre u kërkohet të paraqesin një deklaratë personale që vërteton se nuk kanë qenë pjesë e një partie politike në tre vitet e fundit, si dhe një vërtetim të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që konfirmon se kandidati për anëtar të KKP-së nuk ka kandiduar në zgjedhjet parlamentare apo vendore në

tre vitet e fundit.<sup>22</sup> Kërkesat për paraqitjen e një dokumentacioni të tillë nuk përfshihen as në thirrjet e konkurseve për pozicionet TND.<sup>23</sup> Mungesa e rregulloreve për të garantuar zbatimin e kësaj dispozite ligjore është veçanërisht shqetësuese pasi kandidatët jashtë shërbimit civil mund të konkurrojnë për vendet vakante TND, duke u mundësuar kështu individëve anëtarë të partive politike të hyjnë në radhët më të larta të shërbimit civil.

Raporti vjetor i vitit 2018 i publikuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vëren se nga 17 kandidatët e përzgjedhur për pozicione TND gjatë atij viti, 14 aplikuan jashtë shërbimit civil.<sup>24</sup> Është e rëndësishme të theksohet se megjithëse kandidatët jashtë shërbimit civil mund të aplikojnë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118/2014 përcakton se 80% e kandidatëve të pranuar në TND duhet të jenë nëpunës civilë dhe 20% mund të vijnë jashtë shërbimit civil.<sup>25</sup>

Problemet e integritetit shtohen nga mungesa e përfshirjes së kriterëve specifike për ekspertizë në politika publike gjatë procesit të rekrutimit të nëpunësve të lartë civilë. Njoftimet për konkurset e pranimit në TND nuk përfshijnë pozicionet dhe institucionet specifike të lidhura me to.<sup>26</sup> Rrjedhimisht, kriteret e rekrutimit janë të përgjithshme – pra, nuk janë të orientuara drejt fushës së politikave përkatëse për të cilat institucioni është përgjegjës. Mospërfshirja e kriterëve që lidhen me ekspertizën e nevojshme për politikën publike paraqet një rrezik të shtuar politik dhe në procesin e politikbërjes, pasi nëpunësit e lartë civilë mund të emërohen në çdo institucion të qeverisë qendrore bazuar në lidhje politike, pavarësisht nga ekspertiza – ose mungesa e saj – për politikën e institucionit përkatës.<sup>27</sup>

Një çështje tjetër që lidhet me sigurimin e integritetit të shërbimit të lartë civil është mungesa e kufizimeve ligjore për kohëzgjatjen për caktimin e përkohshëm të nëpunësve të tjerë civilë në një vend vakant TND. Nenet 14 dhe 15 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore rregullojnë kushtet në të cilat mund të bëhen zëvendësime të tilla të përkohshme. Nëse pozicioni i drejtorit të përgjithshëm është vakant, në këtë pozicion caktohet përkohësisht drejtuesi me vjetërsi më të madhe në shërbimin civil në drejtorinë e

përgjithshme. Në mënyrë të ngjashme, nëse pozicioni i sekretarit të përgjithshëm është vakant, caktohet përkohësisht një prej drejtorëve të drejtorive të përgjithshme. Duke qenë se ligji nuk e kufizon kohëzgjatjen e këtyre zëvendësimeve të përkohshme, kjo procedurë paraqet jo vetëm një mundësi për të ruajtur vendin vakant deri në gjetjen e një kandidati të përshtatshëm politikisht, por dëmton në mënyrë të panevojshme efektivitetin e administratës duke i caktuar një nëpunësi civil detyra shtesë për një periudhë të pacaktuar kohore.

## PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Risiqet e integritetit të shqyrtuara në këtë dokument politikash nxjerrin në pah disa nga fushat kryesore ku nevojitet ndërhyrje urgjente pasi ato prekin parimet themelore të meritokracisë dhe profesionalizmit. Përpjekjet për të politizuar shërbimin civil, ose për të dëmtuar integritetin e tij, kanë pasojat të dëmshme për hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Disa nga rastet e shënuara në këtë shkrim tregojnë për rëndësinë e agjencive dhe drejtorive profesionale dhe efikase për të garantuar taksim të drejtë dhe efikas, infrastrukturë cilësore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ato theksojnë gjithashtu mundësinë që kanë partitë qeverisëse për të shfrytëzuar boshllëqe në legjislacionin e shërbimit civil për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në procesin e rekrutimit dhe emërimit në shërbimin civil dhe për zbatimin arbitrar të fushëveprimit horizontal dhe vertikal të Ligjit për Nëpunësin Civil. Përjashtimi nga shtrirja horizontale dhe vertikale e institucioneve qeveritare, që janë të rëndësishme strategjikisht dhe jashtëzakonisht të çënueshme ndaj korrupsionit, është mjaft shqetësuese. Për të trajtuar këto, aktorët institucional mund të marrin parasysh rekomandimet e mëposhtme:

### Për përjashtimet nga Ligji për Nëpunësin Civil

1. Për të sqaruar përjashtimet nga LNC-ja, klauzola "shërbime të tjera shoqërore" ose duhet të hiqet nga përkufizimi për njësitë direkte të ofrimit të shërbimeve, ose këto shërbime të përshkruhen qartë.
2. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil duhet të ketë një mandat të plotë për të ankumuar ligjërisht vendimet e qeverisë që shkelin dispozitat e Ligjit për Nëpunësin Civil, si p.sh. ato që mundësojnë përjashtime arbitrare prej fushëveprimit horizontal dhe vertikal të LNC. Aktualisht, Komisioneri mund të gjobisë zyrtarët publikë për shkelje të administrimit të ligjit. Nuk ka të drejtë shprehimisht të kundërshtojë vendimet e Këshillit të Ministrave që përcaktojnë rregulloret për administrimin e ligjit.<sup>28</sup>

### Mbi integritetin e trupës në nivelit të lartë drejtues

3. Legjislacioni i shërbimit civil duhet të përfshijë standarde dhe rregullore bazë për të siguruar që kandidatët për TND nuk janë anëtarë të një partie politike. Për këtë qëllim, kërkesat ndaj eksperëve të jashtëm të cilët janë kandidatë për anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes – p.sh. për të siguruar dëshmi se nuk kanë qenë anëtarë të një partie politike në tre vitet e fundit – mund të miratohen edhe për kandidatët për TND. Kjo kërkesë do t'u sinjalizonte kategorive më të ulëta të shërbimit civil se anëtarësimi në një parti politike nuk është i nevojshëm për të përparuar në karrierë.
4. Procesi i pranimit në TND nuk i kushton vëmendjen e duhur ekspertizës së politikave – pra, ekspertizës në fushën specifike të politikave për të cilën institucioni është përgjegjës. Kriteret aktuale të rekrutimit të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues duhet të rishikohen për të kërkuar që kandidatët për TND të kenë ekspertizën e nevojshme në fushën e politikave për të cilat është përgjegjës institucioni në të cilin po aplikojnë.
5. Zëvendësimet e përkohshme të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues duhet të kufizohen ligjërisht brenda një kohëzgjatjeje të përshtatshme që nuk ndikon negativisht në efektivitetin institucional.

1. Shih Alban Dafa, National PAR Monitor Albania 2019/2020 (Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2021), <https://bit.ly/3lrJCsJ>.
2. Një shembull i spikatur i këtij këndvështrimi është përdorimi i burimeve materiale dhe njerëzore për fushata politike nga partitë politike në pushtet, të cilat janë paraqitur vazhdimisht në raporte të shumta të OSBE/ODIHR për zgjedhjet vendore dhe parlamentare shqiptare. Shih OSCE, "Elections in Albania", <https://www.osce.org/odihr/elections/albania>.
3. Shih për shembull Gjergji Vurmo, Rovena Sulstarova dhe Alban Dafa, Zbërthimi i Kapjes së Shtetit në Shqipëri: Një Shqyrtim i Rasteve të Korrupsionit Madhor dhe Ligjeve të Bëra me Porosi nga 2008 deri në 2020 (Transparency International dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2021), <https://bit.ly/32GmyzN>.
4. Ligji nr. 8095, datë 21.3.1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:8095:21.03.1996>.
5. Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", <https://qzb.gov.al/eli/ligj/1999/11/11/8549>.
6. Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", <http://www.dap.gov.al/images/Legjislacionishc/Ligji%20152%20perditesuar.pdf>.
7. Fushëveprimi (objekti) horizontal i referohet institucioneve që i nënshtrohen ligjit për shërbimin civil. Fushëveprimi vertikal i referohet klasifikimit/kategorizimit të të emëruarve politikë, nëpunësve publikë dhe personelit mbështetës (administrativ). Shih OECD, Parimet e Administratës Publike (Paris: Botimet OECD, 2017), 47, <http://sigmaweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-edition-2017-ALB.pdf>.
8. Shih OECD, Raporti i Monitorimit: Parimet e Administratës Publike: Albania (Paris: Botimet OECD, 2016), 9-10, <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2016-Albania.pdf>; OECD, Raporti i Monitorimit: Parimet e Administratës Publike: Albania (Paris: Botimet OECD, 2017), 64-65, <http://sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2017-Albania.pdf>.
9. Raporti i Monitorimit (2017), 65.
10. Pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 9.8.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" (i ndryshuar), një nga detyrat kryesore të Agjencisë është "të konsultohet, të propozojë dhe të bashkëpunojë me institucionet e tjera qeveritare për hartimin e politikave të saj për [miradministrimin] e mineraleve, hidrokarbureve dhe energjisë", <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2006/08/09/547>.
11. Pikat 7 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 9.8.2006.
12. Pika 5/a) dhe b) e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2017/11/22/673>.
13. Pikat 13 dhe 16 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 22.11.2017.
14. Neni 15, pika 2 dhe 3/a) dhe b) e Ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/102>.
15. Neni 17, pika 3 dhe neni 19, pika 1 e Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/05/19/9920>.
16. Shih Ligjin nr. 10 164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2009/10/15/10164>.
17. Neni 61 i Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/01/28/9863>.
18. AKSHI është hequr nga lista e institucioneve që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142 datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punonjësve në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", pasi është ndryshuar me VKM nr.3, datë 29.10.2014. <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2014/03/12/142>.
19. Neni 37, pika 2 e Ligjit për Nëpunësin Civil.
20. Vendim KM nr. 118, datë 05.03.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit dhe menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2014/03/05/118>.
21. Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes është një panel përzgjedhës prej nëntë anëtarësh; gjashtë prej anëtarëve duhet të jenë ekspertë të jashtëm të spikatur, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të partive politike për të paktën tre vjet. Kreu II, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 05.03.2014.
22. VKM nr. 118, datë 05.03.2014, kreu II, pika 6, d dhe dh; paragrafi 9, ç dhe dh.
23. Shih, për shembull, shpalljen e konkursit për TND për vitin 2019, [http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-04-20%20TND\\_shpallje%20final.pdf](http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-04-20%20TND_shpallje%20final.pdf).
24. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Raporti Vjetor 2018, 47, <http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2019/06/RAPORT-VJETOR-OF-CCSO-2018.pdf>.
25. Kreu IV, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 05.03.2014.
26. Shpallja për vakancat në TND për vitin 2019 përfshin vetëm kriteret e rekrutimit ndërsa numri i vendeve vakante përfshihet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Shih "Njoftimin për pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)", [http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-04-20%20TND\\_shpallje%20final.pdf](http://dap.gov.al/images/Tnd/2019-04-20%20TND_shpallje%20final.pdf) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 17.4.2019 "Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, edhe për kandidatët jashtë shërbimit civil, dhe për procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019", <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2019/17.04.215>.
27. Përfshirja e kriterëve në lidhje me ekspertizën e politikave do të siguronte që nëpunësit civilë të nivelit të mesëm ose kandidatët e jashtëm, të cilët kanë ndërtuar ekspertizë në një fushë të caktuar të politikës, të emërohen në përputhje me ekspertizën e tyre. Ndonëse shpërndarja e emërimeve në përputhje me ekspertizën mund të bëhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes në bazë të gjykimit të tyre, aktualisht nuk ka dispozita ligjore apo nënligjore që i detyrojnë ata ta bëjnë këtë. Prandaj, hipotetiki, një kandidat i suksesshëm me ekspertizë në politikën energjetike mund të emërohet në një vend vakant TND në ministrinë e Arsimit.
28. Nenet 14 dhe 15, Ligji për Nëpunësin Civil.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e Hanns Seidel Stiftung, zyra e Tiranës. Përbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Hanns Seidel Stiftung.

Për më shumë informacion, vizitoni:

[www.par-monitor.org](http://www.par-monitor.org)

